



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 135 Prot.

Datë 26.01.2022

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 Datë 26.01.2022

PËR

**“ MIRATIMIN E KRITEREVE SPECIFIKE PËR FONDIN 6% TË NDIHMËS
EKONOMIKE PËR VITIN 2022”**

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, Ligji Nr.57/2019, date. 18.07.2019
“Për Asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në VKM nr.597 date 04.09.2019
“Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës
ekonomike dhe përfitimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe
bazuar në Udhëzimin Nr.5 datë 17.02.2017, “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-
ndihmën ekonomike deri në 6%”

VENDOSI

*Miratimin e Kriteriave Specifike për vitin 2022 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit
Bashkiak për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të
kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës
së pikëzimit.*

- 1-Familje të varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat bazë për jetesë.
- 2-Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare më aftësi të kufizuar/invalid pune.
- 3-Familje me shumë fëmijë.

- 4-Persona që jetojnë të vetëm ,të moshuar apo dhe të rinj me probleme social ekonomike.
- 5-Familje me të ardhura të pamjaftueshme që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.
- 6-Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.
- 7-Familje që kanë në përbërje të moshuar,që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
- 8 -Kryefamiljare të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme.

I.Dokumenet e aplikuesve janë sipas VKM nr.955 datë 07.12.2016 ‘Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike’ .

II.Masa e ndihmës ekonomike llogaritet sipas VKM nr.955 datë 07.12.2016 ‘ Për përcaktimin e kriterëve , dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike ‘ dhe Udhëzimit nr.4 datë 17.02.2017 ‘ Për llogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike’’.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Ndihmës Ekonomike.

HARTUESI

Anjeza Doda

JURISTI

Aida Sinani

KRYETARI

Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE
DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 135/1

Pukë më, 26.01.2022

RELACION

PËR

“MIRATIMIN E KRITEREVE SPECIFIKE PËR FONDIN 6% TË NDIHMËS
EKONOMIKE PËR VITIN 2022”

Në zbatim të ligjit **Nr.139/2015** “Për vetqeverisjen Vendore”, Ligji **Nr.57/2019**, date **18.07.2019** “Për Asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë” bazuar në **VKM nr.597** date **04.09.2019** ”Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”si dhe bazuar në Udhëzimin **Nr.5** datë **17.02.2017**,”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”

Në bazë të nevojave që ka Bashkia Pukë dhe në përputhje me ligjin Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social ka paraqitur para Këshillit Bashkiak kriteret specifike të fondit 6% për vitin 2022 për familjet që shpallen jo fituese sipas formulës së pikëzimit.

Sektori i Ndhmës Ekonomike
Anjeza Doda